



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Nr 629 prot

Vau Dejës, me 30 / 03 2022

Lënda: Shpallje vende të lira punë për Shërbimin e MZSH-së, Bashkia Vau Dejës në pozicionin “Luftues/shpëtues/drejtues automjeti dhe punonjës në sallën operuese” 3 (tre) punonjës

Sektorit të Shërbimeve Mbeshtetese dhe TIK në Bashkinë Vau Dejës

Për shpallje

Në mbështetje të ligjit nr.152, dt. 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” Kreu III, neni 14/1 “Pranimi në nivelin bazë të shërbimit të MZSH-së”, në VKM nr. 520, dt. 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Bashkia Vau Dejes shpall vendet e lira në Shërbimin e MZSH-së.

Bashkëlidhur shpallja për publikim.

KRYETAR

Mark BABANI



NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË BASHKINË VAU DEJËS.

KREU I- Pranimi në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07.2019 Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin “Emërimi, lirimi dhe përjashtimi i personelit të Shërbimit të MZSH-së”, Bashkia Vau Dejës njofton se në Sektorin e MZSH-së shpallen **3 (tre)** vende të lira punë në nivelin bazë në pozicionin:

- **“Luftues, shpëtues dhe punonjës në sallën operuese” 3 (tre) pozicione, në nivelin bazë,**

Paga bazë për gradë 40 000 lekë.

Shtesa për natyrë të veçantë punë e shërbimi 7 000 lekë.

KREU II- Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës;

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mara për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. **Luftues, shpëtuesi/drejtues automjeti dhe punonjës në sallën operuese**, është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës. Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

KREU III- Kërkesat e përgjithshme për pranimin;

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;

ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;

d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;

dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).

ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;

f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;

g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;

gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.

h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.

i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.

j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";

k) Kandidati për personelin drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi "D", si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor.

KREU IV- Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit
Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së.

2. Fotokopje e kartës së identitetit ;

3. Saktësim adrese;

4. Çertifikatë familjare;
5. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
6. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
7. Fotokopje deftesë pjekurie;
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Vërtetim i gjendjes Gjyqesore (Dëshmi Penaliteti)/ Formular vetëdeklarimi ;
12. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
13. Çertifikatën qe ka përfunduar me sukses testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës .
14. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
15. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “C”;
16. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
17. (dy) Fotografi (2.5 x 3.5 cm).

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave bëhet pranë Zyrës së Integruar me një Ndalesë në Bashkinë Vau Dejës , brenda datës 11 Prill 2022.

KREU V - Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak;

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak Bashkia Vau Dejes do të shpallë kandidatin që plotëson kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.

Kandidati i kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohet në mënyrë elektronike /email-mesazh, për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

Kandidatët e pa kalifikuar do të njoftohen në mënyrë elektronike /email-mesazh për arsyet e mos kualifikimit.

KREU VI - Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi

- Ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- VKM nr. 520 dt.25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri ”

KREU VII - Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve;

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

- Testi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.
- Testim i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së.) Pikët maksimale të përcaktuara për këtë test janë 100. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.
- Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
- Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në

mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Kandidatët fitues do të renditen sipas numrit të pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njoftimi i fituesit do të shpallet pas përfundimit të afatit të ankimimit.

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SPECIALISTE

Snezhana Gjonaj



DREJTUESI I NJMBNJ

Bib Miria

